

Nr. 630 / prot.
1-2

Tiranë, më 11/05/2015

Drejtuar : Operatorit ekonomik, "DEA SECURITY", shpk, adresë: Rr. Xhorxh W Bush, nr.54/2
Tiranë.

Drejtuar : Operatorit ekonomik, "NAZERI 2000" shpk, adresë, Rr. "Kavajës", Qëndra Condor,
Kulla H, ap.27. **Tiranë.**

Lënda: Mbi përcaktimin me short të "Operatorit ekonomik" fituesit në prokurimin me mjete elektronike me REF - 87725-03-12-2015, me objekt: "Për shërbimin e ruajtjes me roje civile të Universitetit të Arteve, për vitin 2015".

Të nderuar Administratorë,

Sic jeni vënë në dijeni nëpërmjet sistemit elektronik të APP, datë 05/05/2015, për prokurimi me mjete elektronike me REF - 87725-03-12-2015, me objekt: "Për shërbimin e ruajtjes me roje civile të Universitetit të Arteve, për vitin 2015", KVO të Universitetit të Arteve, mbështetur në Vendimin nr.260/2015 prot. datë 29.04.2015, të KPP, Operatorët ekonomik, "DEA SECURITY", shpk dhe "NAZERI 2000" shpk, renditen sipas ofertave ekonomike si vijon:

⇒ Operatori ekonomik, "DEA SECURITY" shpk dhe Operatori ekonomik, "NAZERI 2000" shpk, renditen të dy në vend të parë me ofertë: **1,845,020.43 lekë pa TVSH.**

KPP me Vendimit nr. 260/3/2015 prot. datë 07.05.2015, ka urredhëruar "Hegjen e pezullimit për procedurën e prokurimit "Kërkesë për propozim", me objekt: "Për shërbimin e ruajtjes me roje civile të Universitetit të Arteve, për vitin 2015", me fond limit 2167560 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 30.03.2017, nga autoriteti kontraktor", Universiteti i Arteve.

Në zbatim të detyrimeve ligjore, **pika 8**, të nenit nr.66 (*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*), të VKM nr.914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ju ftojmë **që në datën 14.05.2015, ora 11⁻⁰⁰**, për hedhjen e shortit, për të përcaktuar fituesin në prokurimin me objekt: "Për shërbimin e ruajtjes me roje civile të Universitetit të Arteve, për vitin 2015".

Jeni të lutur të merrni pjesë në hedhjen e këtij shorti.

Operatori ekonomik, do të njoftojë zyrtarisht Universitetin e Arteve, me shkësë pjesëmarrjen brenda **ditës së dytë** të vënies në dijeni të këtij njoftimi.

Para hedhes së shortit, në prezencë të KVO dhe NJP, përfaqësuesi i operatorit ekonomik duhet të dorëzojë një dokument fotokopje të noterizuar, që përfaqëson operatorin ekonomik, sipas këtij njoftimi.

Më poshtë po ju vëmë në dijeni përrregullat e shortit, të miratuar me urdhër të Rektorit të UAR:

1. *"Autoriteti Kontraktor"*, i Universitetit të Arteve, i përfaqësuar nga Rektori i UAR, urdhëron organizimin e shortit midis operatorëve ekonomik për rastet e parashikuara nga **pika 8**, të nenit nr.66 (*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*), të VKM nr.914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
2. Procedurat e shortit organizohen jo më herët se 3 ditë nga urdhëri (*njoftimi i operatorëve*) për shortin. Data, ambjeti dhe ora e zhvillimit të shortit shpallen në faqen zyrtare të UAR (*rubrika e transparencës*) dhe operatorët ekonomik njoftohen edhe shkresërisht;
3. Hedhja e shortit organizohet nga KVO dhe NJP në seancë publike;
4. Në datën dhe orën e caktuar për organizimin e shortit, Kryetari i KVO sigurohet paraprakisht për praninë e përfaqësuesve të operatorëve ekonomik dhë i fton të zënë vendet e caktuara;
5. Në një kuti/enë/ transparente futen aq gogla sa është numëri i operatorëve ekonomik, pjesëmarrës në short;
6. Në secilën prej goglave futet nga një shirit letër **ku në njërin prej tyre** shënohet fjala "**FITUËS**";
7. Radha e térheqjes së goglave, sipas pikës 6, këtij urdhëri, përcaktohet **me parashort**, i cili zhvillohet sipas kësaj procedure:
 - a) Në një kuti/enë/ tjetër transparente futen aq gogla sa është edhe numri i operatorëve ekonomik, pjesëmarrës në short. Në çdo gogël futet një shirit letre në të cilin është shënuar emri i operatorit ekonomik pjesëmarrës në short;
 - b) KVO cakton një anëtar nga NJP, i cili térheq goglën. Operatori ekonomik, emri i të cilit është shënuar në goglën **që térhiqet e para**, do të jetë i pari në radhën e **térheqjes së shortit**, sipas pikës 6, të këtij urdhëri. Në këtë mënyrë procedohet deri në térheqjen e goglës së fundit;




- c) Kryetari i KVO, fton me radhë përfaqësuesit e operatorëve ekonomik për térheqjen e shortit;
- d) **Mosparaqitja** e ndonjë prej përfaqësuesve të operatorëve ekonomik midis të cilëve hidhet shorti, nuk pezullon procedurën e shortit. Në këtë rast procedura për térheqjen e shortit për operatorin ekonomik në mungesë, bëhet nga një person i caktuar me urdhër të Rektorit të UAR;
8. Përfaqësuesi i operatorit ekonomik, pasi e hap goglën, ia dorëzon shiritin e letrës që gjendet brenda saj, Kryetarit të KVO, i cili e lexon me zë të lartë dhe ua tregon të gjithë përfaqësueseve të operatorëve ekonomik, pjesëmarrës në short;
9. Pasi është térhequr gogla me shënimin "**FITUES**", Kryetari i KVO hap me radhë goglat e mbeturë në kuti/enë nëse ka dhe ua tregon ato me radhë pjesëmarrësve në këtë mbledhje të përbashkët të KVO, NJP, përfaqësuesëvë të operatorëve ekonomik, dhe personave të tjera;
10. Në përfundim të procedurës së hedhjes së shortit, KVO merr vendim për shpalljen e rezultatit të shortit;

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

Me konsideratë

Prof. Petrit MALAJ


REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE